

VONESAT NE
ARSYETIMIN DHE DORËZIMIN
E VENDIMEVE GJYQËSORE

Botim nga
Qendra për Çështje të Informimit Publik
INFOÇIP

Tiranë, 17 mars 2014



Botim nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP

© copyright: Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP,
18 Mars, 2014

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Materiali që përmban ky publikim mundet vetëm të citohet me kusht që të njihet autorësia e tij përmes referimit të plotë të atributëve (© copyright, data e botimit, shtëpia botuese, autorët, ISBN, etj).

Një kopje e publikimit që përmban materialin e rishtypur/referuar duhet t'i dërgohet INFOCIP. Çdo përdorim i metodës, të dhënave teorike apo gjetjeve sasiore në këtë studim, për qëllime komerciale ose jo-komerciale nga të tretë është i ndaluar dhe subjekt penalizimi ligjor.

Drejtor i research-it & autor i metodës:

Gerti Shella

Eksptertë të përfshirë në studim:

Ilir Panda
Manjola Bejleri
Artur Selmani
Gerti Shella
Elona Hasko
Blerte Kraja

Koordinatorë të grupit monitorues:

Gejsi Ndoja
Arlinda Selmani

Përpunimi i të dhënave dhe vizualizimi grafik

Sereta Ylli
Gerti Shella

Design Layout

Altin Aliaj

Imazhi në Korpertinë: Në pritje të zbardhjes së vendimit

Shtypur në Tiranë nga: AlbPaper
ISBN:

U realizua në kuadër të projektit:

“Vonesat ne arsyetimin dhe shpalljen e vendimeve gjyqesore-identifikimi i mangesive ne ligj permes analizes krahasuese me legjislacion europian dhe adresimi per zgjidhje”



Ky projekt është mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) në kuadër të programit Shteti i së Drejtës dhe të Drejtat e Njeriut. Mendimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të OSFA-s.

PERMBATJA

KAPITULLI 1 - OBJEKTI, LEGJITIMITETI & GJETJET E MONITORIMIT	7
Mbi objektivat e studimit	9
Baza ligjore për arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve	17
Gjetjet e Monitorimit, Gjykata e Faktit, Tiranë	27
Gjetjet e Monitorimit, Gjykata e Apelit, Tiranë	33
Gjetjet e Monitorimit, Gjykata e Larte e RSH	39
Gjetjet e Monitorimit, Gjykata Kushtetuese e RSH	47
 KAPITULLI 2 - VLERESIMI KRITIK I GJETJEVE DHE PERCAKTIMEVE LIGJORE	 51
Nga Dr. Ilir PANDA: Rruga e gjatë dhe e mundimshme e vendimit nga shpallja deri ne dorëzimin e tij	53
Nga Artur SELMANI: Afatet e shpalljes dhe të arsyetimit të vendimeve penale perfundimtare + analizë legjislative e krahasuar	69
Nga Gerti SHELLA: Hyrja në fuqi e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe efektet e akteve normative me fuqinë e ligjit	87
Nga av. Blerte KRAJA: Afatet e shpalljes dhe të arsyetimit të vendimeve penale perfundimtare + analizë legjislative e krahasuar	95
 KAPITULLI 3 - JURISPRUDENCE DHE COMPENDIUM	 101
Dy fjale për kapitullin “Compendium”	103
Vendimi i KB të GjL nr. 5, dt. 12/12/2013 “Neritan Tabaku vs. KLD”	105
Vendimi Penal i GjL nr. 84 dt. 06/03/2013 “ P.Rr. Sarandë vs. Gaert Çoçka”	139
Vendimi i KB të GjL nr. 38, dt 06/02/2013 “P.Rr.Gj. Vlorë vs. D.L, E.B, J.V.”	145
 Pjese nga Kushtetuta dhe ligje te tjera relevante	 155
Pjese nga KPrC per shpalljen dhe arsyetimin e vendimeve	157
Pjese nga KPrP per shpalljen dhe arsyetimin e vendimeve dhe me interpretime te GjL dhe te GJK	177

LISTA E SHKURTIMEVE

- AP** – Avokati i Popullit
- FZ** – Fletore Zyrtare
- GJEDNJ** – Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
- KiE** – Këshilli i Europës
- GJK** – Gjykata Kushtetuese
- GJL** – Gjykata e Lartë
- GJA** – Gjykata e Apelit
- GJSHP** – Gjykata e Shkallës së Parë
- VGJK** – Vendim i Gjykatës Kushtetuese
- VUGJL** – Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë
- VKB** – Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
- KM** – Këshilli i Ministrave
- VKM** – Vendim i Këshillit të Ministrave
- MD** – Ministria e Drejtësisë
- KB** – Kolegjet e Bashkuara
- QBZ** – Qendra e Botimeve Zyrtare
- KPrC** – Kodi i Procedurës Civile (në disa raste: **KPC**)
- KPrP** – Kodi i Procedurës Penale (në disa raste: **KPP**)
- RSH** – Republika e Shqipërisë
- INFOÇIP** – Qendra për Çështje të Informimit Publik

FALENDERIME

Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOÇIP, falenderon expertët e përfshirë në këtë studim. Kontributi i tyre në vlerësimin e përcaktimeve ligjore për afatet e arsytimit të vendimeve, si dhe në identifikimin e problemeve që hasen në praktikë për këtë çështje, ka qenë mjaft i rëndësishëm. Bashkëpunimi me ta krijoi për INFOÇIP një standart të ri në ndërveprimin me aktorët e sistemit të drejtësisë, me dobi të padiskutueshme.

Një falenderim i veçantë shkon për kryetarët e gjykatave që targetoi ky monitorim, të cilët mirëpritën ekipet monitoruese dhe lejuan akses në të të dhënat që administron gjykata, posaçërisht ato që lidhen me dorëzimin e çështjeve gjyqësore të përfunduara.

INFOÇIP falenderon veçanërisht kryetarin e Gjykatës së Lartë të RSH, z. Xhezair Zaganjori për sensin e lartë të bashkëpunimit dhe hapjes ndaj aktorëve të shoqërisë civile të cilët monitorojnë punën e gjykatave. Po ashtu, INFOÇIP i shpreh mirënjohjen e thellë edhe kreut të Gjykatës së Apelit, Tiranë, z. Alaudin Malaj për mirëkuptimin dhe lehtësitë e jashtëzakonshme që ai krijoi gjatë implementimit të këtij studimi.

*INFOÇIP falenderon edhe Sekretaritetë Gjyqësore në gjykatat **që targetonte ky studim, për gjithë ndihmën** dhe bashkëpunimin e ofruar në mbledhjen e të dhënave parësore që analizoi ky studim. Personeli i sekretariave gjyqësore u tregua gjithmonë i disponueshëm, pavarësisht presionit të kohës dhe ngarkesës së punëve të përditshme.*

Një falenderim i fundit, por jo për nga rëndësia, shkon për Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, i cili mbështeti idenë e INFOÇIP për realizimin e këtij studimi, i cili i hap rrugën në të ardhmen vlerësimeve të tjera, me një mbulim edhe më të shtrirë gjeografik. Bashkëveprimi me stafin e OSFA i krijoi grupit të punës lehtësirat e duhura për të përfunduar me sukses të gjithë procesin kompleks të monitorimit dhe vlerësimit të të dhënave.

KAPITULLI I

OBJEKTI, LEGJITIMITETI
&
GJETJET E MONITORIMIT

1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.
2. Gjykata e Lartë duhet t'i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës.
3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Neni 142. Kushtetuta e Shqipërisë

MBI OBJEKTIVAT E STUDIMIT

NGA **GERTI SHELLA**

DREJTOR I STUDIMIT

Konstatimi fillestar

Raportet e vjetore **“Transparenca e Botimeve Zyrtare në RSH”**, të hartuara nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, (INFOÇIP), kanë konstatuar çdo vit vonesa në shpalljen e arsyetuar të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe mandej mangësi të botimit të këtyre vendimeve në Fletore Zyrtare. Gjykata e Lartë përfaqëson majën e piramidës gjyqësore në RSH, kurse vendimet unifikuese janë ndër aktet e saj më të rëndësishme, pasi ato njësojnë shqyrtimin gjyqësor në gjykatat e shkallëve më të ulëta. Sipas ligjit, vendimet e Gjykatës së Lartë duhet të shpallen shpallen të arsyetuara jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor. Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare¹.

Vlerësimet e INFOÇIP sugjerojnë se vonesat në arsyetimin e vendimit bëheshin shkak për vonesa në shpalljen /dorëzimin e tij në sekretari. Kjo sillte më pas vonesa në botimin e tyre në Buletin apo në faqen zyrtare të GJL. Tek vendimet unifikuese, vonesat në arsyetim dhe dorëzim reflektoheshin më pas tek botimi i tyre në Fletore Zyrtare. Kjo e fundit madje ka akumuluar ndër vite mangësi serioze sa i takon botimit të vendimeve unifikuese².

1 neni 19/1 & 19/3, ligji 8588, dt. 15.03.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar..



Përveçse një shkelje e dispozitave të ligjit organik nga Gjykata e Lartë, këto vonesa kanë prodhuar shpesh shkelje të lirive dhe te drejtave themelore të individit, të përcaktuara në Kushtetutë dhe në KEDNJ, dhe që të cilat GJL e ka detyrim kushtetues t'i garantojë. Rasti më flagrant i konstatuar nga INFOÇIP është ai i ish-të dënuar P. D. i cili qëndroi padrejtësisht në burg 5 muaj më shumë për shkak të mos-zbardhjes të një Vendimi Unifikues të Gjykatës së Lartë³. Po në 2009-ën, e njëjta situatë rëndoi edhe për të dënuar Xh. Hoxha. Për të dyja rastet, u hartua rekomandim edhe nga Avokati i Popullit⁴.

Pavarësisht vonesave flagrante të hasura në 2009-ën, raporti i vitit 2011⁵, hartuar po nga INFOÇIP, konstatoi se situata në GJL nuk u përmirësua sa i takon shpalljes së vendimeve në afat. Madje, vonesat vijuan të pësonin rritje. E përkeqësuar mbeti edhe botueshmëria e tyre në Fletore Zyrtare⁶.

Implikimi logjik që INFOÇIP artikuloi që në vitin 2011 ishte: **përderisa vendimet unifikuese të GJL arsyetohen dhe dorëzohen në tejkallim të afateve ligjore, në gjykatat e shkallëve më të ulëta problemi mund të ishte masivisht i përhapur.**

Pikënisja për ndërhyrje të re

Problematika e shpalljes me vonesë të vendimeve gjyqësore ka gjetur trajtim, edhe pse mund të tingëllojë paradoksale, në jurisprudencën e vetë Gjykatës së Lartë⁷. Po ashtu, kjo çështje është trajtuar disa herë rrjesht nga Gjykata Kushtetuese⁸. Këto gjykata kanë theksuar se mos-shpallja e vendimeve brenda afateve të arsyeshme bie në kundërshtim me ligjin procedural dhe cënon të drejtën kushtetuese të të gjykuarit për ankim dhe akses në gjykatë, për shkaqe që rrjedhin nga gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore. **Kështu, shpallja e vendimit përfundimtar të arsyetuar është detyrim ligjor me pasojë pavlefshmërinë e tij...**

Po sipas jursiprudencës vendase, arsyetimi ligjor i vendimit është një element

2 Gjatë vitit 2013, në fletore zyrtare rezultoi i botuar vetëm një vendim unifikues (Vendim i GJL nr.3, dt. 8.7.2013, FZ. 163, dt.11 Tetor, 2013) nga të paktën 5 të tillë që janë dhënë nga Kolegjet e Bashkuara të GJL (burimi: INFOÇIP)

3 Vendimit nr. 2, i dhënë në 06.02.2009, u botuar në F. Zyrtare 125, në dt. 24.08.2009.

4 më dt. 02.06.2009 me shkresë nr.K2/R2-7. Shih "Transparenca e Botimeve Zyrtare në RSh, 2009", fq. 29: Rasti "Deliu", kliko: http://INFOÇIP.org/Raporti_web.pdf

5 Mbështetur nga Partnership for Transparency Fund, PTF, Washington D.C.

6 Sa për ilustrim, vendimi unifikues civil nr.6, dt.1/6/2011, u botua në Fletore Zyrtare 2 vjet pasi përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, konkretisht në FZ nr.171, 29 Tetor, 2013. Po ashtu, vendimi unifikues civil i KB të GJL, me nr.3, dt. 29.3.2012, u botua në FZ. Nr. 179, dt 11 Nentor, 2013, pra me mbi një vit e gjysëm vonesë. (burimi INFOÇIP)

7 Vendimet e Gjykatës së Lartë nr. 38/2013 dhe nr. 84/2013. Po ashtu, së fundmi edhe vendimi i Kolegjeve të Bashkuara nr.5, dt.12.12.2013, i cili botohet i plotë në kapitullin compendium të këtij botimi.

8 Psh. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 5/2011

i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor i cili ka për qëllim: a) *ushtrimin e kontrollit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë* dhe b) *ushtrimin e kontrollit publik në administrimin e drejtësisë*. Të dy këta elementë lidhen ngushtësisht me të drejtën e ankimit të subjektit procedural pasi kontrolli gjyqësor nuk ushtrohet në mënyrë incidentale, por mbi bazën e shkaqeve të ngritura nga palët në proces. Kufizimi në kohë i së drejtës së ankimit lidhet me përcaktimin jo vetëm të detyrimit të gjykatës për ta arsyetuar vendimin përfundimtar por edhe dorëzimin e vendimit në sekretarinë gjyqësore....

Trajtim edhe më të hollësishëm ky problem gjen në jurisprudencën e GjEDNJ-së, ku, për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e një gjyqi është apo jo e arsyeshme, duhet të merret parasysh e gjithë periudha nga momenti i depozitimit të kërkesë-padisë deri sa vendimi merr formë të prerë (depozitohet në sekretari). Një zgjatje e tepruar nga seanca e fundit deri në nxjerrjen e një vendimi të arsyetuar mund të cënojë të drejtën e gjykimit pa vonesa të panevojshme dhe të pengojë mundësinë e palëve për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e ankimit. Në rastin e Shqipërise kjo e fundit është e parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës.

Në referim të vendimeve të GjEDNJ⁹, por edhe praktikës së saj në përgjithësi “case law”, gjykatat vendase kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “*të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*”. Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, garanton mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor ndaj “*vonesave të tepruara procedurale*”, që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës. Një drejtësi jo efikase dhe e vonuar çon në dëmtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit. Drejtësia e vonuar është e njëjtë me drejtësinë e mohuar (Magna Carta). Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar. Siç edhe është parashtruar më sipër në këtë vendim, në çështjet gjyqësore periudha e arsyeshme që merret në konsideratë për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi i arsyetuar merr formë të prerë.

Në çështjen *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, GjEDNJ-ja doli në përfundimin se mosdhënia e një vendimi të arsyetuar për të akuzuarin në kohën e duhur nuk i dha atij mundësi (kohe dhe mjete të mjaftueshme) të paraqiste argumentet e tij për t’u ankuar në Gjykatën e Kasacionit. Kjo cënoi të drejtën për një gjykim të drejtë. Mosdhënia nga ana e gjykatës e vendimit të arsyetuar me shkrim brenda një kohe të arsyeshme solli si pasojë mos-lejimin e të paditurit për

9 PGV kundër Italisë, vendimi i GjEDNJ, datë 7.11.2000; Çështja X kundër Francës, 1998; Vocaturo kundër Italisë; Cappello kundër Italisë; Darvan kundër Turqisë, 2009; Zimmermann dhe Steinner kundër Zvicrës, datë 13.06.1983; Vendimi K.Klitshe de la Grande kundër Italisë, 27.10.1994; Poiss kundër Austrisë, datë 23.04.1097. Vendimi “Hadjianastassiou kundër Greqisë, 16.12.1992

të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e tij sipas legjislacionit vendas për rishikimin e vendimit nga një gjykatë më e lartë.

Pavarësisht jurisprudencës së pasur nga gjykatat vendase dhe ndërkombëtare, vemendja mediatike dhe më pas ajo e aktorëve të drejtësisë për problemin në fjalë ishte “e vakët” deri në 13 shtator 2012, kohë në të cilën ndodhi vrasja tragjike e komisarit të policisë Adem Tahiri nga shtetasi I. Xhakja. Nga verifikimi që organet e hetimit dhe MD i bënë rrethanave që çuan në këtë krim të rëndë, u evidentua dhe fakti i mos-apelimit prej prokurorisë të një çështjeje penale në proces, në ngarkim të shtetasit I.XH. Nga vlerësimet rezultoi se, edhe pse kishte përfunduar shqyrtimi i çështjes penale¹⁰ në ngarkim të tij në Gjykatën e Durrësit, arsyetimi dhe dorëzimi i vendimit në sekretarinë gjyqësore ishin vonuar me muaj të tërë.

Në mes të Shtatorit 2012, ndoshta për herë të parë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë regjistroi edhe procedimi penal ndaj gjyqtarit të çështjes “*për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, lidhur me mos-zbardhjen dhe mos-depozitim brenda afateve ligjore të vendimit gjyqësor penal nr.98, dt 9.2.2011, duke cënuar rëndë interesat e ushtrimit të ndjekjes penale në kohë ndaj shtetasit Ilir Xhakja*”¹¹ dhe dhënies së drejtësisë¹².”

Në çështjen penale kundër të pandehurit Xhakja rezulton se procesi gjyqësor ka zgjatur rreth 1 vit e 7 ditë, ndërsa **vendimi i arsyetuar është dorëzuar pas 1 viti, 7 muaj e 5 ditë nga data e shpalljes së tij** (e dyta tejkalon ndjeshëm edhe vetë kohën e shqyrtimit gjyqësor).

Çështja e mos-zbardhjes prej gjyqtarit N.T. të vendimit penal nr.98, dt 9.2.2011 për një kohë kaq të gjatë, ndoshta nuk do të kishte rënë në sy, e aq më pak do ishte bërë problem nëse komisar i policisë A. Tahiri nuk do të ishte vrarë në krye të detyrës....Hetimi nxorri në pah se vonesa të ngjashme ishin aplikuar edhe në rreth 60 dosje të tjera të shqyrtuara nga i njëjti gjyqtar¹³.

* * *

Duke vendosur në sfond rrethanat e mësipërme, në mesin e vitit të kaluar INFOÇIP i propozoi Fondacionit Soros në Tiranë (OSFA) të mbështeste realizimin e një monitorimi të situatës së vonesave në arsyetimin dhe dorëzimin (zbardhjen) e vendimeve gjyqësore. Për arsye të rëndësisë specifike dhe të volumit të çështjeve¹⁴, në fokus u vendosën Gjykata e Shkallës së Parë dhe e Apelit Tiranë. Pjesë e vlerësimit do të ishin edhe vendimet e Kolegjeve të Bashkuara

10 Vendimit gjyqësor penal nr.98, dt 9.2.2011

11 Mbi këtë shtetas ka rënduar akuza e vrasjes së komisarit policies së Shijakut, Adem Tahiraj.

12 Cituar fjale per fjale nga njoftimi i shpërndare nga zyra e shtypit e Prokurorisë së Përgjithshme me dt. 17 shtator 2012 (http://www.balkanweb.com/bë_lajme2.php?IDNotizia=102847&IDCategoria=1).

13 *Burimi: Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të GJL nr 5, dt. 12.12.2013* (Nr.1 i Regji Themeltar), Ankues Neritan Tabaku.

14 Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit në Tiranë kanë numrin më të lartë të çështjeve në një vit kalendarak krahasuar me çdo gjykatë tjetër në RSH.

të Gjykatës së Lartë, pjesë e të cilave janë edhe vendimet për njehsimin dhe ndryshimin e praktikës së shqyrtimit gjyqësor (vendimet unifikuese). Për këto të fundit, objekt vlerësimi do të ishte edhe koha/vonesat e botimit të tyre në Fletore Zyrtare, një detyrim ligjor ky që buron nga dispozitat e nenit 19/3 të ligjit 8577/2000 “për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës së Lartë”.

Po ashtu, në terma të kohës së botimit në Fletore Zyrtare do të vlerësoheshin edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, edhe pse kjo e fundit ka juridiksion të posaçëm, jashtë sistemit gjyqësor me tre nivele në RSH. Ky vlerësim është disi i ndryshëm krahasuar me objektin parësor të këtij studimi, pasi nuk trajton apo mat kohën nga marrja e vendimit deri në arsyetimin e tij, por kohën nga shpallja e arsyetuar e vendimit deri në hyrjen e tij në fuqi.

Metodologjia e përzgjedhur nga INFOÇIP konsiston në mbledhjen sistematike të të dhënave mbi datat e dorëzimit në sekretarinë gjyqësore të vendimeve përfundimtare (dosjes gjyqësore pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor) dhe më pas vlerësimin e vonesave eventuale duke kontrastuar datën e dhënies së vendimit me datën e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Një metode e tillë aplikohet për herë të parë analizon të gjitha vendimet një për një të regjistruara në varg indeksues të rregullt në numratorët e çështjeve gjyqësore që administrohen nga sekretaritë e gjykatave. Pra metoda e INFOÇIP nuk proceson një numër të reduktuar çështjes (30-40) të zgjedhura përmes kampionimit të rastësishëm, por të gjitha vendimet e dorëzuar në një kohë të dhënë. Intervali minimal kohor mbi të cilën zbatohet analiza është katër muaj, kurse më i larti është një vit i plotë kalendarik.

Për të realizuar këtë vlerësim, paraprakisht ishte i domosdoshëm identifikimi me saktësi i dispozitave në korpusin e brendshëm ligjor (kode dhe ligje) të cilat përcaktojnë afatet e arsyetimit/dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Veçimi i tyre dhe vlerësimi apo adresimi korrekt i mangësive të hasura është një tjetër objektiv parësor i këtij studimi.

E përmbledhur, identifikimi dhe grumbullimi i të dhënave për datat e dorëzimit të vendimeve në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të Apelit Tiranë, si dhe të vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara të GJL gjatë vitit 2013 e më pas kontrastimi i gjetjeve me përcaktimet ligjore përkatëse, të identifikuara paraprakisht me ndihmën e ekspertëve të mirënjohur, cakton kufijtë dhe legjitimitetin e këtij monitorimi.

Lidhur me afatet e arsyetimit të vendimeve, penale dhe civile, në të treja shkallët e gjyqësorit, duket se Shqipëria aplikon standarte ligjore “të mjegullta”, ndryshe nga shumica e vendeve të tjera europiane. Ballafaqimi i dispozitave shqiptare për këtë hallkë të posaçme procedurale (afatet e arsyetimit/dorëzimit të vendimeve) me ato të vendeve të tjera europiane, përfshirë Kosovën, ka qenë një tjetër objektiv

i këtij studimi. Kjo analizë krahasuese realizohet për herë të parë dhe përfaqëson një tjetër vlerë të shtuar në kuadër të trajtesave të këtij studimi. Krahasimi i dispozitave shqiptare me ato të vendeve më të përparuara, legjislacioni i të cilave në disa raste është përzgjedhur për të modeluar atë shqiptar, kuadraton një terren të pasur me rekomandime dhe sugjerime për përmirësime konkrete në të ardhmen sa i takon afateve në dispozicion të gjyqtarëve për të garantuar arsyetim cilësor dhe në kohë të vendimeve gjyqësore përfundimtare. Po ashtu, kjo analizë krahasuese tenton të hedhë më shumë dritë mbi disa përcaktime të errëta, ende të pashtjelluar mirë nga jurisprudenca vendase, lidhur sidomos me koncepte të tilla si “dispozitivi i vendimit”, “dhënia e vendimit dhe shpallja e arsytuar e tij”, “arsyetimi si premisë ankimimi”, etj..

Botimi përmban një kapitull të posaçëm (*compendium*) ku janë të grupuara të gjitha nenet / dispozitat përkatëse të kodeve dhe ligjeve të cilat përcaktojnë afatet për shpalljen / zbardhjen / arsyetimin e vendimeve gjyqësore në të treja shkallët e gjyqësorit. Po ashtu, në këtë kapitull është përfshirë edhe një pjesë e jurisprudencës më relevante të Gjykatës së Lartë mbi çështjen që ka në fokus ky studim, pikërisht afatet dhe vonesat në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore.

Konkretisht, autorët e këtij botimi kanë zgjedhur të përfshijnë vendimin nr.5, dt. 12/12/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (me palë ndërgjyqëse gjyqtari N. Tabaku dhe KLD). Ky vendim dhe arsyetimet që ai përmban janë shumë të rëndësishme në raport me vetë qëllimin e Përmbledhësës në veçanti dhe të këtij studimi në tërësi. Vlen të theksohet fakti se, në momentin e mbylljes dhe dërgimit për botim të këtij studimi (dt. 16 Mars 2014), gjyqtarët e mendimit të pakicës në këtë vendimarrje, ende nuk i kishin përfunduar argumentimet e tyre. Rrjedhimisht, vendimi është publikuar në këtë pëmbledhje jo në formën e tij përfundimtare, pra ku duhet të jetë i përfshirë si rregull edhe mendimi i pakicës.

Përmbledhësja ligjore (*Compendium*) targeton në mënyrë të posaçme gazetarët të cilët mbulojnë gjyqësorin dhe/apo kanë një interes profesional për të raportuar me saktësi çështje që *ngërthejnë* edhe afatet e arsyetimit e mandej dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Të gjitha nenet, dispozitat përkatëse janë të nënvizuara, për një identifikim dhe përdorim (referim) të lehtë dhe praktik në rutinën e përditshme profesionale të gazetarëve.

Po ashtu, kjo Përmbledhëse (*Compendium*) mund t'i hyjë në punë fare mirë edhe të gjithë praktikantëve të ligjit, apo studentëve të drejtësisë, për një shfletim të shpejtë e të saktë të atyre dispozitave ligjore mbi afatet e shpalljes, arsyetimit, dorëzimit dhe ankimit të vendimeve penale dhe civile në të treja shkallët e Gjyqësorit. Kjo përbën një tjetër risi të botimit.

Të dhënat e gjeneruara në terren, analizat e legjislacionit dhe vlerësimet krahasuese me legjislacionin e vendeve të tjera, synojnë ndër të tjera të “*shtrojnë rrugën*” edhe për një vlerësim *shkak-pasojë* në të ardhmen të raportit midis ngarkesës së trupës gjyqësore dhe vonesave të konstatuara në dorëzimin e dosjeve në sekretari pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor. Kjo analizë, edhe pse dytësore në raport me objektivat e projektit, përfaqëson një nga implikimet kryesore të studimit dhe shërben për përpunimin e rekomandimeve lidhur me shtimin / pakësimin e trupës gjyqësore (në rastin konkret, në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit në Tiranë).

Kjo analizë e posaçme synohet të ndërmerret nga INFOÇIP me rastin më të parë pas shpalljes publike dhe diskutimit të gjetjeve të përmban ku studim, i cili ndër të tjera targeton edhe vendimarrësit në nivel qëndror ekzekutiv (Ministria e Drejtësisë), që kanë në kompetencë hartimin e organikës së gjykatave (caktimin e numrit të trupës gjyqësore dhe administratës së gjykatave).

Vlen të theksohet se rekomandimet e këtij studimi janë të inkorporuara në trajtesat që ai përmban dhe jo në një kapitull të veçantë. Ekspertiza e diversifikuar dhe kompetenca profesionale e ekspertëve të përfshirë në studim diktuan paraqitjen integrale të rekomandimeve, pra të pa-shkëputura nga parashtrimet dhe analiza e të dhënave apo argumentave që trajtohen.

Domosdoshmëria e shpalljes së vendimeve gjyqësore brenda afateve kohore të arsyeshme është adresuar së fundmi edhe nga Raport Progresi i Komisionit European për Shqipërinë, për vitin 2013. Në Kapitullin 23 të këtij dokumenti “*Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut*”, theksohet se *vendimet gjyqësore dorëzohen të paarsyetuara dhe në shumicën e rasteve shpallen pas një vonesa të konsiderueshme*¹⁵. Ky dokument shërben për autoritetet shqiptare në orientimin e politikave që duhet të ndërmerren për të krijuar të gjitha kushtet dhe standardet e nevojshme për t’u anëtarësuar në BE.

Shpresojmë që analizat, vlerësimet dhe rekomandimet e këtij studimi voluminoz, të realizuar nga INFOÇIP në bashkëpunim me ekspertë dhe profesionistë të njohur të sistemit gjyqësor, të shërbejnë si një instrument efikas për gjyqtarët dhe autoritetet përgjegjëse të shtetit shqiptar, në orientimin më të mirë të përpjekjeve të tyre në përmirësimin e sistemit gjyqësor. Po ashtu, INFOÇIP shpreson që gjetjet e këtij monitorimit të meritojnë vëmendjen e medias, por edhe të aktorëve të shoqërisë civile shqiptare, që punojnë me përkushtim çdo ditë edhe për rritjen e eficiencës së sistemit gjyqësor në Shqipëri.

**Tiranë,
17 Mars, 2014**

15 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013_en.pdf (page 38, para.7)



GJETJET E MONITORIMIT, 2013

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË, TIRANË

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë realizon numrin më të madh të shqyrtimeve gjyqësore krahasuar me çdo gjykatë tjetër analoge në RSH. Kjo Gjykatë jep mesatarisht në një vit mbi 15 mijë vendime për çështje nga më të ndyshmet, ku pjesa dërmuese janë civile. Ngarkesa për këto të fundit vjen vazhdimisht në rritje çdo vit (7-10%), ndërkohë që trupa gjyqësore e kësaj gjykate mbetet pothuajse e pandryshuar¹. Objekt vlerësimi i këtij monitorimi janë afatet e arsyetimit/dorëzimit të vendimeve civile në Gjykatën e Faktit, Tiranë gjatë 4-mujorit **Janar - Prill 2014**.

Deri më sot nuk ka patur vlerësime të posaçme, koherente apo metodologjiksht cilësore, lidhur me vonesat që hasen në arsyetimin e vendimeve në shkallë të parë. Nuk ekziston asnjë matje rigoroze e kohës që pason shpalljen e dispozitivit të vendimit në seancë e deri në momentin kur vendimi i arsyetuar dorëzohet në Sekretarinë e Gjykatës². E thënë ndryshe, fenomeni i vonesave njihet dhe pranohet, por përmasat e tij reale nuk janë **”fotografuar”** asnjëherë. Rrjedhimisht, dhe ato pak rekomandime që aktorë të interesuar mund të kenë adresuar, mbeten më shumë **”dëshira të mira”** se sa konkluzione të bazuar mbi të dhëna të forta (të besueshme).

Për të gjeneruar pikërisht këto të dhëna të besueshme (*hard evidence*), mbi të cilat më pas të mund të përpunohen rekomandime solide, INFOÇIP vendosi t'i largohej metodave vlerësuese me kampionim (*që përzgjedhin 20-30 çështje për analizë*) dhe të vlerësojë në bllok integral të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata që është objekt monitorimi. Vlerësimi në këtë rast aplikohet një për një ndaj çdo vendimi për një periudhë të pandërprerë kohore. Konkretisht, INFOÇIP mori në analizë 4756 vendimet civile³ të dhëna nga Dhomës Civile e Gjykatë së Faktit, Tiranë gjatë katër-mujorit **Janar - Prill 2013**. Këto çështje përfaqësojnë pak a shumë 1/3 e totalit të vendimeve të dhëna gjatë vitit 2013. Tabela dhe **graf. 1** paraqesin të dhënat për llojin e çështjeve/vendimeve, sipas numratorit civil të kësaj Gjykate:

1 Dhoma Civile e kësaj gjykate ka 52 gjyqtarë. Burimi: <http://www.gjykatatirana.gov.al/>


2 OSBE ka tentuar në mëse dy raste të masë këtë interval sensitiv, por metoda e përdorur ka gjenruar të dhëna të cilat nuk e vizualizojnë fenomenin, por vetëm e konstatojnë atë (Raporti “Drejt Drejtësis”, 2012, 2013”).

3 Burimi: Regjstri (Numratori) i Çështjeve Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2013


GJ. FAKTIT, TIRANE - KLASIFIKIMI I ÇESHTJEVE SIPAS LLOJIT (JANAR-PRILL, 2013)

NR	KLASIFIKIMI I ÇESHTJEVE (EMERTIMI)	NR. VENDIMESH
1	PRANUAR	2501
2	RREZUAR	435
3	PRANUAR PJESERISHT	340
4	PUSHUAR	1271
5	KTHIM AKTESH	145
6	INTERKOMPETENCA	49
7	PAJTUAR	12
8	REFUZUAR	2
9	BASHKIM CESHTJESH	1
	TOTAL CESHTJE	4756

Graf.1



Për të lehtësuar analizën, metoda e përdorur nga INFOÇIP “filtroi” për përpunim të mëtejshme vetëm vështjet të cilat rezultojnë “**të pranuar**”, “**të pranuar pjesërisht**”, dhe “**të rrëzuara**”, gjithsej në total 3268 vendime. Këto lloj vendimesh mund të konsiderohen “klasike” në kuptimin që shpallja e dispozitivit të tyre dhe arsyetimi që pason, mund të kontrastohen drejtpërdrejt me afatet që cakton neni 308 i KPr.C.



Graf.2

Sipas një arsyetimi interpretues të nenit 308 të KPrC, në procesin e dhënies së një vendimi gjyqësor përfundimtar, presupozohet se gjyqtari **duhet ta shpallë atë të arsyetuar dhe, të nënshkruar, ta dorëzojë menjëherë në sekretari**. Në qoftë se çështja është e ndërlikuar, dhe të tilla sigurisht që ka, gjyqtari ka dy alternativa: 1- të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit dhe ta dorëzojë vendimin të arsyetuar brenda dhjetë ditëve ose, 2- ta shtyjë shpalljen e vendimit por, brenda pesë ditëve, ta shpallë atë të arsyetuar (*shih më gjerësisht interpretimet nga I. Panda, fq.55*)

Neni 308

(Ndryshuar paragrafi I me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 58)

Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën "kundër" dhe nënshkruan vendimin.

Në çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në pesë ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai ia beson këtë njërit prej anëtarëve të trupit gjykues.

Nga 3268 vendimet e analizuar gjatë katër-mujorit Janar-Prill 2013, rezulton se vetëm vetëm 34 prej tyre janë dorëzuar në sekretari brenda 24 orëve⁴ nga momenti (data) e marrjes së vendimit. Kjo përfaqëson vetëm 1% të totalit të vendimeve nën vlerësim prej kësaj analize.

Shumica dërrmuese e vendimeve rezulton se janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari nga 2-10 ditë pas shpalljes. Janë 1851 vendime ose 56.6% e totalit prej 3268 vendimesh të analizuar, arsyetimi i të cilave ndodh praktikisht në një kohë të dytë. Në rastin konkret, pra për 56% të rasteve, koha për arsyetimin e vendimit, pas shpalljes më parë të dispozitivit, varion nga 2-10 ditë. Ky interval përfaqëson 56.5% të rasteve. Në një interpretim të drejtpërdrejtë të dispozitave që përmban neni 308 i KPrC, këto vendime përkojnë me ato që konsiderohen "çështje të ndërlikuara".


Nga analiza rezulton se 647 vendime, ose 21% e totalit, janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari nga 11-15 ditë pas shpalljes së vendimit. Ndërkohë, përtej limitit 15 ditor, i cili është kritik për shkak të afateve të ankimit, rezultojnë se janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës plot 709 vendime, ose 21.7% e totalit të marrë në analizë (*shih: graf. 3*)

Studimi ka grupuar në një grup më vetë vendimet të cilat janë dorëzuar të arsyetuara në sekretarinë e gjykatës 15 ditë pas shpalljes së vendimit. Në këtë grup gjenden edhe vendime që rezultojnë të jenë dorëzuar edhe me 3 muaj vonesë.

4 Intervali "24-orë" nuk përshkruan besnikërisht atë që në kuptimin e nenit 308 do të konsiderohej "dorëzim menjëherë në Sekretari". Për të lehtësuar përlogaritjet, autorët e studimit ranë dakort për konvencion që 24-orëshi të konsiderohet një tautologji për "dorëzim të menjëhershëm".


EVIDENCE PERMBLEDHESHE PER DITEVONESA - PERIUDHA JANAR - PRILL 2013

NR	EMERTIMI	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	Nga 0 deri 1 ditë	34	1.04
2	2 deri në 10 ditë	1851	56.64
3	11 deri në 15 ditë	674	20.62
4	Mbi 15 ditë	709	21.70
	TOTAL	3268	100



Graf.3

Nëse do t'i përmbaheshim interpretimit të afateve të dorëzimit të vendimit të arsyetuar sikurse përcakton neni 308 i KPrC (shih fq. 31) dhe t'i ndanim vendimet civile të marra në analizë vetëm në dy kategori: (a) dorëzuar/arsyetuar brenda afatit 10 ditor, dhe (b) dorëzuar/arsyetuar përtej afatit 10 ditor, atëherë do të kishin një vizualizim edhe më të thjeshtuar të situatës së vonesave në Gjykatën e Tiranës (grafiku nr.4)



Graf.4



Konkluzionet e monitorimit për vendimet civile në Gjykatën e Faktit, Tiranë

Nga monitorimi
rezultoi se:

Në katër muajt e parë të vitit 2013 nga 3268 vendime përfundimtare për çështje civile të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, plot 1383 prej tyre, ose rreth 42% e totalit të analizuar, janë arsyetuar dhe/ose dorëzuar në Sekretarinë e Gjykatës përtej limitit 10 ditor që cakton KPrC.

Nëse do ta
riformulonim
këtë konkluzion
në terma të
zbatueshmërisë
së ligjit, do të
rezultonte se:

Dhoma Civile e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, ka mundur të zbatojë deri në masën 58% përcaktimet ligjore mbi afatin maksimal të lejuar nga neni 308 i KPRC për dorëzimin e arsyetuar të vendimit përfundimtar në sekretarinë e gjykatës gjatë periudhës Janar-Prill 2013 (për pranimin, pranimin pjesërisht dhe rrëzimin e padisë).

Automatikisht
mund të
pohohet se:


Në 42% të rasteve të analizuara (3268 gjithsej), Dhoma Civile e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë (Gjykata e Faktit) ka tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara në KPrC për arsyetimin dhe dorëzimin në sekretari të vendimt gjyqësor përfundimtar.

Në rastin më të mirë, shkelja e afateve të arsyetimit /dorëzimit të vendimeve civile në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë mund të ketë ardhur si rezultat i:


1. Numrit të pamjaftueshëm të trupës gjyqësore për të përballuar në kohë dhe me cilësi volumnin e çështjeve që gjykohen, në rastin konkret edhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore (civile) përfundimtare.
2. Numrit gjithnjë në rritje të padive civile në këtë Gjykatë, çka ka rritur progresivisht ngarkesën individuale të gjyqtarëve viti pas viti, dhe që reflektohet në tashmë dukshëm në vonesa në arsyetimin / dorëzimin e vendimeve prej tyre.
3. Kompleksitetit në rritje të çështjeve të cilat gjykohen, arsyetimi i të cilave është i komplikuar dhe rrjedhimisht kërkon më shumë kohë se sa KPrC ka vendosur në dispozicion të gjyqtarëve në shkallën e parë të gjykimit

REKOMANDIME DIREKTE


Nëse zgjedhim ta shohim “gotën gjysëm plot”, pra të jemi pozitivistë dhe proaktivë përballë këtyre treguesve, pa konsideruar faktorët që lidhen me rastin më të keq, problemi mund të adresohet në të paktën tre përfaqje:



1) duke shtuar numrin e gjyqtarëve të Dhomës Civile në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, për një shpërndarje më të mirë të ngarkesës së gjyqtarëve



2) duke rritur kohën në dispozicion të gjyqtarëve për arsyetimin e vendimeve përfundimtare përtej limit 10-ditor apo 15 ditor, të përcaktualisht aktualisht në neni 308 të KPrC, duke amenduar këtë të fundit me synim zgjatjen e këtyre afateve.



2) duke aplikuar monitorim të vazhdueshëm nga aktorë të specializuar (qeveritarë ose jo-qeveritarë) ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve, me fokus të posaçëm afatet e arsyetimit dhe dorëzimit të vendimeve gjyqësore.

Nëse pyetja shtrohet se cili prej këtyre tre rekomandimeve logjike duhet zgjedhur, mjafton që në analizë të futen edhe dy tre gjykata të tjera të shkallës së parë, të cilat, ndryshe nga ajo e Tiranës, përballen me një ngarkesë që konsiderohet “normale” për shqyrtimin e çështjeve civile dhe, nëse në këto gjykata treguesit e afateve do të rezultojnë më në përputhje me afatet që cakton neni 308 i KPrC, atëherë ndoshta thjesht rritja e trupës gjyqësore në Tiranë do mjaftonte për të normalizuar situatën. Në të kundërt, rritja e afateve në Kod mund të ishte një qasje me efikase. Sigurisht, një analizë e tillë do të duhej të bashkë-shoqërohej edhe me një vlerësim cilësor të arsyetimit të vendimeve nga gjyqtarët. Por, shtjellimi i këtij subjekti i kapërcen caqet e analizës dhe rekomandimeve që ky studim merr përsipër të realizojë.





GJETJET E MONITORIMIT, 2013

GJYKATA E APELIT, TIRANË

Gabimet gjyqësore dhe keqzbatimi i së drejtës materiale dhe procedurale janë probleme që hasen në të gjitha sistemet gjyqësore, ku edhe ai shqiptar nuk bën përjashtim. Për këtë arsye, shqyrtimi gjyqësor me nivele, është i domosdoshëm për të “filtruar” dhe për të “korrigjuar” vendimet që merren nga gjykatat e shkallëve më të ulëta. Për shkak të rëndësisë së tyre në zgjidhjen e gabimeve të mundshme të drejtësisë dhe funksionit të tyre “udhëzues” kundrejt gjykatave të ulta, është thelbësore që gjykatat e apelit t’i kryejnë veprimtaritë e tyre në përputhje sa më të plotë me ligjin dhe mbi të gjitha me një cilësi më të lartë se gjykatat e shkallëve më të ulëta. Pra, cilësia më e lartë e vendimeve gjyqësore në Apel është një implikim që buron nga vetë definicioni për **gjykatat më të larta**. Pjesë substanciale e cilësisë së pretenduar është arsyetimi i vendimeve gjyqësore prej tyre, i cili duhet të jetë profesional, bindës dhe t’i serviret palëve në një kohë sa më të shpejtë. Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar dhe vlerësuar, lejon vlerësimin e publikut ndaj sistemit të drejtësisë dhe është një kërkesë e domosdoshme për të përgatitur një ankim qenësishëm⁵ dhe në mënyrë efektive.

Përgjithësisht aktorët e interesuar⁶ që kanë hulumtuar vendimarrjen në Apel janë përqëndruar rëndom tek cilësia e argumentimit të vendimeve. Pra, objekt i interesimit të tyre qenë (1) *nëse ka apo nuk ka arsyetim vendimi*, **dhe** (2) *nëse ky arsyetim është klishe apo autentik*.

Ka patur fare pak përpjekje (për të mos thënë fare) për të matur dhe vlerësuar situatën që lidhet me vonesat në arsyetimin / dorëzimin e vendimeve në Apel.

Në fakt, çdo pretendim / rekomandim për arsyetime më cilësor të vendimeve në Apel, do të ishte i cungët nëse çështja do të veçohej apo abstragohej nga

5 Dhe jo një ankim mekanik, i cili vihet në lëvizje nga palët pa u njohur më parë, apo domosdoshmërisht, me arsyetimet e gjykatës.

6 Kryesisht organizata apo misione ndërkombëtare, dhe shumë pak aktorë vendas (ministra, Konferenca Gjyqësore, KLD, etj)

faktori “kohe”. Për këtë arsye, monitorimi i ndërmarrë nga INFOÇIP fokusohet “ekskluzivisht tek koha” brenda të cilës arsyetohen vendimet në Apel. Kjo matje realizohet për herë të parë dhe përfaqëson një risi. Metoda e përdorur nga INFOÇIP konsiston në vlerësimin një për të një të gjitha vendimeve, penale dhe civile, të dhëna në Apel gjatë një periudhe të dhënë.

Për shkak të rëndësisë shumë të madhe specifike, në fokus të këtij monitorimi u vendos Gjykata e Apelit Tiranë, e cila realizon dhe volumin më të madh të shqyrtimeve gjyqësore në një vit, krahasuar me të gjitha gjykatat e tjera të apelit në vend.

Siç rezulton edhe nga vlerësimet teorike të këtij studimi, KPrC nuk ka të parashikuar një afat eksplicit brenda të cilit gjyqtarët e Apelit arsyetojnë vendimet e marra/shpallura prej tyre. Praktika sugjeron se gjyqtarët e Apelit përlogarisin me analogji afatin (në dispozicion të tyre) brenda të cilit vendimet duhet të dorëzohen në Sekretarinë Gjyqësore. Ky afat, sipas tyre, është 20 ditë.

Për vendimet penale në Apel, KPrP nuk parashikon ndarje në kohë për shpalljen e dispozitivit dhe arsyetimin e vendimit. Ato janë pjesë integrale e të njëjtit vendim që duhet të shpallet me të gjithë elementët e tij (neni 383) me anë të leximit në seancën që cakton edhe mbylljen e shqyrtimit gjyqësor. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes...(neni 386/1). Lajmërimi për depozitimin dhe kopja e vendimit i njoftohen të pandehurit që është deklaruar në mungesë (neni 386/2). Graf. 5 “fotografon” situatën e “menjëhershmerisë” së dorëzimit të vendimeve penale (afati: brenda 24 orësh).

Neni 112 i KPrP përcakton se vendimi duhet të arsyetohet, ndryshe ai është i pavlefshëm. Origjinalet e akteve të gjykatës (ku përfshihen edhe vendimet) depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre (neni 113). Përcaktimet që përmbajnë këto dy nene mund të interpretohen lidhur me afatin e dorëzimit në sekretari të vendimit penal përfundimtar edhe në Apel, i cili në këtë rast do të ishte jo më shumë se 5 ditë. Grafiku 7 (fq. 34) ofron një paraqitje të situatës së dorëzimit të vendimeve penale, vlerësuar mbi këtë afat 5-ditor.

Për arsye që diktohen nga dy pararafët e mësipërm, INFOÇIP vendosi që periudha kohore e vlerësimit për Gjykatën e Apelit Tiranë të mbulonte një vit kalendarik (në fakt 11 muaj, nga Janari deri në 3 Dhjetor 2013). Në këtë mënyrë mund të “fotografohej” qartë praktika që ndiqet me synim përpunimin e rekomandimeve solide. Në rastin e vendimeve civile, kohëzgjatja mesatare e arsyetimit të një vendimi mund të shërbejë si një rekomandim direkt për caktimin e këtij intervali në dispozitatat pëkatëse të KPrC, për të shmangur në këtë mënyrë edhe interpretimet mbi këto afate, çka gjyqtarët e Apelit bëjnë aktualisht.


Sa i takon vendimeve penale, vlerësimi i situatës për 11 muaj rrjesht ofron një pikëmbështetje solide për të adresuar fenomenin e vonesave me synim ndërmarrjen e ndryshimeve në Kod, bazuar edhe në praktikat e vendeve të tjera (shih analizën krahasuese nga I.Panda dhe A. Selmani tek Kapitulli II).

Rezultatat e monitorimit për vendimet penale në Gjykatën e Apelit, Tiranë

Nga Janari deri në 3 Dhjetor 2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka dhënë 1048 vendime penale. Prej tyre, vetëm 10 janë dorëzuar në sekretari brenda 24 orëve të parë. Kjo përbën më pak se 1% të totalit. Pjesa tjetër, ose 99% e vendimeve penale janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari përtej këtij afati (Graf. 5)

NR	EMERTIMI	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	NGA 0 DERI 1 DITE	10	1
2	MBI 2 DITE	1,038	99
	TOTAL	1,048	100

Graf.5



Nga 1048 vendime penale të dhëna në 11 muaj të 2013-s, brenda 24 orëve janë dorëzuar vetëm 10 prej tyre ose 1%; 1038 vendime (99%) janë dorëzuar në tejkalim të afatit që përcaktojnë dispozitat e nenit 386 të KPrP.


Grafiku 6 (faqja tjetër) ofron një vizualizim më të detajuar të ditë-vonesave të dorëzimit të vendimeve penale në Sekretari, të grupuara në më shumë intervale kohore. Është e rëndësishme të nënvizohet se 24 vendime penale janë dorëzuar në sekretari pas më shumë se 30 ditëve, çka përfaqëson një kapërcim të afatit përtej të cilit nuk mund të paraqitet më rekurs nga palët në GJL. Siç e përcakton qartë edhe neni 435 i KPrP, *rekursi duhet të paraqitet me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë. Ai duhet të përmbajë tregimin e saktë të shkaqeve të paligjshmërisë së vendimit.* Pra, njohja me arsyetimin e vendimit duhet konsideruar si një kusht logjik (a-priori) që palët të mund të paraqesin shkaqet e paligjshmërisë së vendimit të Apelit në GJL.

EVIDENCE PERMBLEDHESE PER DITEVONESA - PERIUDHA: 3 JANAR - 3 DHJETOR 2013

GJYKATA APELIT TIRANE - Çështje Penale


NR	INTERVALI KOHOR	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	NGA 0 DERI 10 DITE	610	58.21
2	NGA 11 DERI 20 DITE	270	25.76
3	NGA 21 DERI 30 DITE	144	13.74
4	MBI 30 DITE	24	2.29
	TOTAL	1,048	100

Graf.6



Neni 113 i KPrP përcakton se “Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim”. -Vendimet e Apelit janë në këtë kuptim akte të gjykatës, madje të ankueshme. Nëse do zgjidhnim t’i referoheshim këtij afati 5-ditor si limit brenda të cilit duhen dorëzuar vendimet penale në Sekretari, **Graf. 7** vizualizon një situatë tjetër:

Graf.7




Si përfundim:

Nga 1048 vendime penale të dhëna në 11 muaj, viti 2013, brenda 5 ditëve u dorëzuan në sekretari vetëm 27% e tyre; 761 vendimet e tjera penale, ose 73% e totalit të analizuar u dorëzuan në tejkalim të afatit që cakton neni 113 i KPrP

Rezultatat e monitorimit për vendimet civile në Gjykatën e Apelit, Tiranë

Nga Janari deri në 3 Dhjetor 2013, Gjykata e Apelit, Tiranë ka dhënë 2549 vendime civile. Të gjitha këto vendime janë analizuar nga INFOÇIP një për një, për të ballafaquar datën e vendimit me datën e dorëzimit të tij në Sekretarinë e Gjykatës. Grafiku 8 indikon se vetëm 23 vendime civile janë dorëzuar brenda 24 orëve të para. Rreth 45% e totalit të vendimeve civile rezultojnë të jenë dorëzuar në Sekretarinë e Gjykatës së Apelit, Tiranë brenda 10 ditëve nga marrja e tyre.

NR	INTERVALI KOHOR	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	NGA 0 DERI 1 DITE	23	0.90
2	2- 10 DITE	1,137	44.61
3	11- 20 DITE	699	27.42
4	21-30 DITE	371	14.55
5	MBI 31 DITE	319	12.51
	TOTAL	2,549	100




Grafiku 8 indikon se 371 vendime civile në Apel ose rreth 15% e totalit të marrë në analizë gjatë 2013 janë arsyetuar/dorëzuar në intervalin kohor 21-30 ditë pas dhënies së vendimit. Po ashtu, 319 vendime civile janë dorëzuar në sekretarinë e gjykatës përtej 31 ditësh (ose një muaj nga dhënia e vendimit).

Gjyqtarët e Apelit, në veprimtarinë e përditshme, i referohen me analogji rastit të shpalljes vetëm të dispozitivit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë, ku ligji le në dispozicion 10 ditë për dorëzimin e tij të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore. Kjo përfaqëson 2/3 e afatit që ligji ka caktuar për paraqitjen e ankimit në gjykatën e apelit kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë (15 ditë). Mbi bazën e këtij proporcioni, 2/3 e afatit 30-ditor, që ligji ka caktuar për rekursin në GJL kundër vendimeve të Apelit, rezulton të jetë 20 ditë. Kjo përfaqëson për gjyqtarët e Apelit edhe afatin limit për dorëzimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore.

Është interesant fakti që sugjeron **grafiku 9** më poshtë, sipas të cilit, edhe koha prej 20 ditësh për arsyetimin / dorëzimin e vendimit civil, nuk ka rezultuar e mjaftueshme për rreth 690 vendime civile (ose 27% e totalit) në Gjykatën e Apelit, Tiranë gjatë periudhës që mbuloi kjo analizë (3 Janar-3 Dhjetor 2013).

NR	INTERVALI KOHOR	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	NGA 0 DERI 20 DITE	1,859	72.93
2	MBI 20 DITE	690	27.07
	TOTAL	2,549	100



Graf.9

Si përfundim:

Nga 2549 vendime civile apeli, marrë në 11 muaj të 2013-s brenda afatit 20-ditor u dorëzuan vetëm 27% e tyre; 1859 vendime ose 73% janë dorëzuar në Sekretari në tejkalim të afatit që vetë gjyqtarët e Apelit e përlogarisin si prag limit.

Ndër 3579 vendime civile dhe penale të Gjykatës së Apelit, Tiranë, të analizuara nga INFOÇIP në intervalin kohor 3 Janar -3 Dhjetor 2013,

Vonesa më e madhe e konstatuar në dorëzimin e një vendim civil është 188 ditë (vendim nr. 1169, dt. 20/05/2013 rezulton i dorëzuar në dt. 25 Nëntor 2013)

Vonesa më e madhe e konstatuar në dorëzimin e një vendim penal është ditë (vendim nr. 796, dt 20/10/2013 vijonte i padorëzuar deri në 3 Dhjetor 2013 kur u mbyll vlerësimi)



GJETJET E MONITORIMIT, 2013

GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata e Lartë e RSH, me seli në Tiranë, është shkalla më e lartë e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Misioni i saj kryesor është rishikimi, me kërkesën e palëve, i vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulta. Nëpërmjet këtij procesi, ajo merr në shqyrtim çështjet e zbatimit të ligjit pa gjykuar faktet duke garantuar me anë të jurisprudencës së saj zbatimin uniform të ligjeve. Për këtë arsye, ligji nr.8588 dt.15/03/2000 “*Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë*” i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe shpalljes dhe botimit të vendimeve të kësaj gjykate. Neni 19 i ligjit në fjalë¹, përcakton shprehimisht se:

(1) Vendimet e Gjykatës së Lartë shpallen të arsyetuara jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor. (2) Vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimet e pakicës, botohen në Buletinin Periodik të Gjykatës së Lartë. (3) Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ (neni 10/1). Çështjet me karakter tregtar, civil dhe familjar gjykohen nga Kolegji Civil; çështjet penale gjykohen nga Kolegji Penal; çështjet me karakter administrativ dhe të punës gjykohen nga Kolegji Administrativ (neni 12).

Gjykata e Lartë gjykon në Kolegjet e Bashkuara: a) *rastet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale*; b) *ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë*; c) *kërkesat për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore*; ç) *raste të tjera, të parashikuara me ligj (neni 14).*

Objekt vlerësimi në kuadër të këtij monitorimi do të jenë pikërisht afatet e arsyetimit dhe dorëzimit të vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara gjatë vitit 2013. Rëndësi e posaçme do t'i kushtohet vendimeve për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, ose siç njihen ndryshe, vendime *unifikuese* (shkut: VUGJL). Këto vendime, përveçse duhen shpallur të arsyetuara brenda 30 ditësh, duhet edhe të botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare (neni 19, para.1 dhe 3).

Prandaj, sa i takon këtyre lloj vendimeve, objekt vlerësimi do të jenë: (1) botimi i tyre në FZ dhe (2) koha e botimit në FZ nga momenti i dhënies së vendimit prej Kolegjeve të Bashkuara.

¹ file:///C:/Documents%20and%20Settings/user/My%20Documents/Downloads/ligji_gjykates_se_larte%20(2).pdf

1. Rezultatet e monitorimit për vonesat në arsyetimin e Vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara të GJL, viti 2013

Gjatë vitit 2013, Kolegjet e Bashkuara të GJL kanë dhënë gjithsej 8 vendime: 5 janë vendime civile, kurse 3 penale. Prej këtyre 8 vendimeve, 5 janë unifikuere (*shih tabela më poshtë*).

Në faqen zyrtare të GJL, mund të shkarkohet një buletin i vendimeve të marra nga Kolegjet e Bashkuara gjatë vitit 2013. Në këtë buletin janë grupuar 6 vendime gjithsej, dhënë nga Kolegjet e Bashkuara gjatë 2013-ës (4 civile dhe 2 penale). Në këtë Buletin mungojnë pikërisht vendimi penal nr.2 dhe vendimi civil nr.1.

Vendimi civil nr.5, i cili është i përfshihet në këtë Buletin, rezulton ende i pa-kompletuar me mendimin e pakicës², një kërkesë kjo e cila buron nga neni 19 (fjalë e dytë) e ligjit 8588 dt.15/03/2000.

PËRMBAJTJA			
Nr.i vendimit	Data	Çështje Civile	Page
		PALET	
1	0.2013	<i>konkret</i>	
2	19.06.2013	Shoqëria "Siga." SH.A. kundër Sëkel Karanaj	
3	06.12.2013	Fever Ajdari kundër Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shpërndarë Tiranë	
4	10.12.2013	Hazir Kuka në mungesë, Agji Kuka në mungesë kundër Ibrahim Lika, K.K.K.Fronave Qarku Dibrë. Drejtoria e Bujqësisë Mat, Agjencia Kombëtare e Privatizimit Dibrë	
5	12.12.2013	Ankues: Neritan Tabaku kundër K.L.D Tiranë	
		Çështje Penale	
1	19.06.2013	Kërkesë: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i pandehur: Stilian Vathi	
2	01.2013	Të pandehur:	
3	08.07.2013	Kërkesë: Ylli Çelhaka	
	01.2013	Të pandehur:	

Faksimile e buletinit të GJL për vendimet e Kolegjeve të Bashkuara, viti 2013

Lidhur me afatet e arsyetimit / dorëzimit të vendimeve të KB gjatë vitit 2013, nga monitorimi rezulton se të gjitha këto vendime janë arsyetuar/dorëzuar në tejkallim të afateve ligjore, siç sugjeron tabela përballë (*ngjyre portokalli*).

Deri në datë 15 Mars 2014, në Sekretari nuk ishte dorëzuar ende vendimi unifikuues penal nr.2. Ky vendim rezulton të jetë marrë që në datë 18 Qershor 2013 (datë në të cilën është mbyllur shqyrtimi gjyqësor). Nga një përlllogaritje e thjeshtë del se arsyetimi dhe/apo dorëzimi (i firmosur nga shumica dhe nga pakica) i këtij vendimi është vonuar me rreth 9 muaj (deri në dt. 15 mars 2014). Një vonesë me rreth 8 muaj verifikohet ndërkohë edhe për vendimin unifikuues penal nr.1 (*shih tabela*). Ndër vendimet civile më të vonuara në arsyetim /dorëzim rezulton ai me nr.1, me rreth 4 muaj nga data e marrjes. Pakica ende nuk kishte përmbysur arsyetimet e saj deri në datë 15 mars 2014, pavarësisht se një fakt i tillë nuk e ka penguar sekretarinë t'i shpërnda një palëve të interesuara kopje të vendimit në fjalë.

2 Kundër vendimit të shumicës janë shprehur gjyqtarët Andi ÇELIKU dhe Edmond ISLAMAJ: <http://www.gjykataelarte.gov.al/>

Numer i vendimit	Lloji i vendimit	Palet ndergjyqese	Dt. e vendimit /mbyllja shqyrtimit	Data e zbardhjes ³	Vendimi i arsyetuar (shumica + pakica)	Dite -vonesa nga marrja e vendimit. (deri 15.3.2014)	Dite-vonesa tej afatit ligjor te shpalljes (-30 d) (deri 15.3.2014)
1	Civil	A.HYSI KUNDER.....	17/06/2013	22/07/2013	04/11/2013 <i>Pakica ende jo</i>	135	105
2	Civil	SHOQËRIA "SIGAL" SHA vs. SOKOL KANANAJ	19/06/2013	22/07/2013	13/11/2013	128	98
3	Civil unifikues	ENVER HAJDARI vs. DREJTORIA RAJONALE INSTITUTIT TE SIG. SHOQËRORE, TIRANE.	06/12/2013	20/12/2013	21/02/2014	75	45
4	Civil unifikues	A. KUKA-H. KUKA vs. IBRAHIM LIKA, K.K.K PRONAVE QARKU DIBER, DREJ. E BUJQËSISE MAT, AKP...	10/12/2013	15/01/2014	03/03/2014	81	51
5	Civil	NERITAN TABAKU vs. KESHILLI I LARTE I DREJTËSISE	12/12/2013	23/01/2014	18/02/2014 <i>Pakica ende jo</i>	67	37
1	Penal unifikues	PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, vs. I PANDEHUR: STILIANVATHI	19/06/2013	10/02/2014	18/02/2014	240	210
2	Penal unifikues	GJERGJI LEKA vs. PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË	18/06/2013	12/03/2014	<i>As Shumica, as Pakica</i>	265	235
3	Penal unifikues	YLLI CELHAGA vs. PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJE	08/07/2013	16/09/2013	03/10 /2013	85	55
TOTAL						1076 dite	836 dite

Edhe për vendimin civil nr.5 të KB, pakica ende nuk kishte përfunduar arsyetimet e saj deri në dt. 15 Mars 2014. Me një llogari të thjeshtë, pakica ka kapërcyer me mbi 2 muaj kohën afatet që i jep në dispozicion neni 19 i ligjit 8588/2000 për të përfunduar arsyetimet e veta. Vendimi civil nr.5 i KB ka një rëndësi specifike në këtë studim, pasi trajton posaçërisht problematikën e shkëljes së afateve të arsyetimit dhe dorëzimit të vendimeve gjyqësore nga vetë gjyqtarët. Ky vendim botohet i plotë në këtë studim, pavarësisht se me fjalën “i plotë” në këtë rast duhet kuptuar **vendimi + pjesa e arsyetimeve të shumicës** (lexoje në fq.107).

Në total, deri në datë 15 mars 2014, përllogariten rreth 836 ditë vonesa, ose rreth 2.3 vjet për dorëzimin e 8 vendimeve të KB të 2013-ës, në formatin përfundimtar (arsyetimi i shumicës + pakicës + firmosje e vendimit).

Shifra prej 836 vonesash rezulton pasi është zbritur më parë ajo që konsiderohet afat ligjor prej 30 ditësh në dispozicion të gjyqtarëve për arsyetimin nga shumica dhe pakica, e dorëzimin e vendimeve në sekretari. Konkretisht koha e skontuar është **30 ditë x 8 vendime = 240 ditë**. Ditë-vonesat vijnë në shtohen akoma, pasi për vendimin penal nr.2, sipas sekretarisë, edhe shumica edhe pakica ende nuk kishin arsyetuar dhe/apo firmosur ende deri në mes të Marsit 2014. Po ashtu, shtimi i vonesave mund të pohohet edhe në rastin kur me marreveshje do të pranohet që një vendim i pa-arsyetuar ende nga pakica nuk mund të konsiderohet një vendim i dorëzuar. Të tilla vendime, ende të pakompletuara me arsyetimet e pakicës deri në 15 Mars 2014 janë VKB civil nr.1 dhe VKB civil nr. 5.

3 Data e zbardhjes është një koncept që është ndërfutur në këtë tabelë për rigorozitet formal, meqenëse, sipas praktikës së ndjekur në sekretarinë e GJL, pavarësisht formosjes apo mos-kompletimit të vendimit me arsyetimin e të gjithë anëtarëve të KB, ai mund të shpëndahet për palët me kërkesë të këtyre të fundit. Megjithatë, kjo praktikë është jo-relevanten si në terma të legjitimitetit të këtij monitorimi

2. Rezultatate e monitorimit për botimin në Fletore Zyrtare të vendimeve unifikuese të GJL gjatë vitit 2013

Nga tetë vendime gjithsej të marra nga Kolegjet e Bashkuara gjatë 2013-ës, pesë prej tyre janë vendime unifikuese (*shih tabela në fq. 47*). Për këto lloj vendimesh, neni i 19 i ligjit 8588/2000 përmban një detyrim të dyfishtë: përveçse duhen shpallur të arsyetuara brenda 30 ditëve, ato duhen botuar në numrin më të parë të Fletores Zyrtare, pra në një kohë sa më të shpejtë të mundshme. Arsyeja e këtij përcaktimi në ligj lidhet me faktin se përmes VUGJL sigurohet uniformiteti në interpretimin e ligjeve në procesin gjyqësor prej të gjithë trupës së gjyqtarëve në RSH.

Mos-botimi i VUGJL në Fletore Zyrtare do të ishte së pari një shkelje nga vetë GJL e dispozitave të ligjit të saj organik (*fjalë 1 dhe 3, neni 19*). Së dyti, kjo do të sillte potencialisht si pasojë mos-përmbushjen e qëllimit të synuar nga ligjvënësi, por edhe nga vetë GJL, sa i takon unifikimit të praktikës gjyqësore në RSH. Siç u tha më sipër, arsyeja pse ligjvënësi ka përcaktuar që këto lloj vendimesh duhet të botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare, ka të bëjë me faktin se ato duhet të njihen sa më shpejt që të jetë e mundur nga trupa gjyqësore e gjykatave më të ulëta, me qëllim që praktika, tashmë e unifikuar përmes interpretimit ligjor të Gjykatës së Lartë, të reflektohet në kohën e duhur në çështjet e ngjashme që janë ende nën shqyrtim gjyqësor apo që pritet të shqyrtohen.

Bazuar në parashtrimet e mësipërme, vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në kuadër të këtij monitorimi do të vlerësohen përveçse në terma të afateve të zbardhjes edhe në terma të botimit të tyre në fletore zyrtare.

Deri në dt. 3 mars 2014³, nga 5 vendime unifikuese të dhëna nga GJL gjatë vitit 2013, vetëm njëri prej tyre gjendej i botuar në Fletore Zyrtare. Ky është vendimi unifikues penal nr.3, dt. 8/7/2013⁴ dhe gjendet i botuar në FZ nr. 163. Kjo FZ ka dalë në qarkullim në datë 11 Tetor, 2013.

Deri në datë 5 mars 2014, moment i cili përkon me interesimin e INFOÇIP pranë GJL për tërheqjen tashmë nga sekretaria të vendimeve të tjera unifikuese, asnjë nga 4 VUGJL e tjera nuk ishte i botuar në ndonjë fletore zyrtare të 2013-s apo 2014-s. Si për “koencidence”, disa ditë pas marrjes së këtij kontakti direkt me

3 Ky është momenti kur INFOÇIP mori kontakt të drejtpërdrejtë me sekretarinë e GJL për të marrë informacion për vendimet unifikuese dhe mosbotimin e tyre, pas konsumimit të pritjes 60 ditore pas mbylljes së vitit 2013, kohë gjatë së cilës bëhën publikimet finale të Fletoreve Zyrtare që mbyllin serinë e botimeve vjetore.

4 Vendimi penal nr.3, dt. 8/7/2013 “Me objekt kundërshtimin e urdhrat të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë me nr.43, datë 2.4.2012, për ekzekutimin e vendimit penal nr.19, datë 24.3.2000 (nr.36, datë 23.4.2007) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.”

GJL, QBZ nxorri në qarkullim elektronik FZ me nr. 215⁵ dhe 216⁶. Në të parën (215) është botuar vendimi unifikues civil nr.3, kurse në të dytën (216) gjenden të votuar dy vendime unifikuese, ai penal nr.1 dhe civil nr.4.


Këto dy fletore zyrtare mbyllin serinë e botimeve për vitin 2013. Në kopertinat e tyre shënohen respektivisht datat 6 dhe 7 mars 2014, por vetë botimi nuk ofron ndonjë të dhënë tjetër shtesë lidhur me datën e formulimit, hyrjes dhe daljes nga botimi të formatit në letër të këtyre dy fletoreve.

Deri në dt 17 mars 2014, ditë në të cilën ky studim u mbyll dhe u dërgua për botim në shtypshkronjë, nuk u botua ndonjë fletore zyrtare tjetër, ku mund të kërkohej për ndonjë vendim tjetër të prapambetur. Fletorja zyrtare nr.216 e datës 7 Mars 2014, mbyll serinë e botimit për vitin 2013, rrjedhimisht edhe përlllogaritjet e mëposhtme për botimin e vendimeve unifikuese të vitit 2013 në FZ do të bëhen mbi këtë seri botimi (shih *print-screen* të faqes zyrtare të QBZ, dt 17 Mars 2014).

Si përfundim,
deri në
17 Mars 2014,
rezultonte se:

Në serinë e FZ të vitit 2013, nuk ishte botuar ende Vendimi Unifikues Penal nr.2 i cili është marrë që në datë 18/06/2013 nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Print Screen
i faqes zyrtare
të QBZ,
dt 17 Mars 2014



Fletoret e publikuara gjatë vitit 2013

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45
46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75
76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100	101	102	103	104	105
106	107	108	109	110	111	112	113	114	115	116	117	118	119	120
121	122	123	124	125	126	127	128	129	130	131	132	133	134	135
136	137	138	139	140	141	142	143	144	145	146	147	148	149	150
151	152	153	154	155	156	157	158	159	160	161	162	163	164	165
166	167	168	169	170	171	172	173	174	175	176	177	178	179	180
181	182	183	184	185	186	187	188	189	190	191	192	193	194	195
196	197	198	199	200	201	202	203	204	205	206	207	208	209	210
211	212	213	214	215	216									

Ekstra 89
Ekstra 90

5 http://qbz.gov.al:81/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/215-2013.pdf

6 http://qbz.gov.al:81/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/216-2013.pdf

3. Rezultatate e monitorimit për botimin në Fletore Zyrtare të vendimeve unifikuese të GJL nga viti 2011 deri 2013

Krahasuar me volumin e vendimet normale që GJL nxjerr çdo vit, vendimet unifikuese përfaqësojnë një numër shumë të vogël. Pavarësisht kësaj, këto lloj vendimesh përfaqësojnë jurisprudencën më të rëndësishme të GJK, pasi përmes tyre unifikohet (njehsohet) shqyrtimi gjyqësor në gjykatat e shkallëve më të ulëta. Këto vendime botohen në Fletore Zyrtare që trupa gjyqësore dhe aktorë të tjerë të procesit civil, penal, administrativ, etj, të marrin dijeni mbi normën e re që caktojnë këto vendimi dhe ta reflektojnë atë në kohë në vendimarrjen gjyqësore.

Vonesat në arsyetimin e VU bëhen shkas për vonesa në botimin e tyre në Fletore Zyrtare. Kjo është një lidhje e dukshme shkak-pasojë, pasi VU mund të procesohen për botim në FZ nga QBZ vetëm në formën e tyre përfundimtare, ku sigurisht përfshihet arsyetimi i vendimit si nga shumica edhe nga pakica.

Neni 142 i Kushtetutës përcakton qartë se “Gjykata e Lartë duhet t’i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës” (para.2). Botimi i VU tyre realizohet si përmes buletinit që harton vetë GJL, ashtu dhe përmes FZ (neni 19/2 & 3, ligji 8588). Edhe në ligjin e ri për QBZ (nr. 96/2012), në listën e akteve që QBZ proceson për botim përmenden në mënyrë eksplicite vendimet për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore të GJL⁷ (shkurt: vendime unifikuese).

Meqë, siç edhe u tha më sipër, çdo vit kalendarik GJK nxjerr një numër të pakët vendimesh unifikuese, me synimin për të gjeneruar një trend solid sa i takon vonesave në botimi e tyre në FZ, INFOÇIP vendosi të analizojë VU të nxjerra gjatë tre viteve të fundit, 2011, 2012 dhe 2013. Siç sugjeron tabela e gjelbër perballë, gjatë këtyre tre viteve Kolegjet e Bashkuara të GJL kanë dhënë 21 vendime unifikuese.

Mesatarja e vonesës absolute për këto 21 vendime të marra së bashku është 320 ditë. “Vonesa absolute” është koha që përlllogaritet nga data e vendimit (përkon me datën e seancës së fundit) e deri në botimin e tij në Fletore Zyrtare.

Në total absolut, 21 vendimet unifikuese të tre viteve të fundit, të marra së bashku, kanë “pritur” rreth 6731 ditë, ose 18.4 vjet nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor për të parë “dritën e botimit” në Fletore Zyrtare.

⁷ Ligj nr. 96/2012, Neni 2 “Qëllimi”:

“Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për botimin e ligjeve, të akteve normative të Këshillit të Ministrave, ministrave dhe drejtuesve të institucioneve qendrore, vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, vendimeve për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjitha akteve të tjera, botimi i të cilave është i detyrueshëm me ligj, në funksion të bërjes së mundur të hyrjes në fuqi të tyre, si dhe për të garantuar njohjen e legjislacionit dhe garantimin e së drejtës për informim të personave fizikë dhe juridikë, si dhe institucioneve shtetërore”.

VITI	TOTAL	ATRIBUTETE E VENDIMIT UNIFIKUES TE GJL	LLOJI	FLETORJA ZYRTARE (FZ) KU ËSHTË BOTUAR VUGJL	VONESA ABSOLUTE	VONESA E PERLLOGARITUR PER BOTIM NE FZ
2013	1	Vendim unifikues nr.3, date 06.12.2013	Civil	Nr. 215, dt. 06.03.2014	90 dite	45 dite
	2	Vendim unifikues nr.4, date 10.12.2013	Civil	Nr. 216, dt. 07.03.2014	86 dite	41 dite
	3	Vendim unifikues nr.1, date 19.06.2013	Penal	Nr. 216, dt. 07.03.2014	260 dite	215 dite
	4	Vendim unifikues nr.2, date 18.06.2013	Penal	ende nuk ka shkuar per botim	mbi 270 dite dhe rritet....	225 dite
	5	Vendim unifikues nr.3, date 08.07.2013	Penal	Nr. 163 dt. 11.11.2013	125 dite	80 dite
2012	1	Vendim unifikues nr.2, date 27.03.2012	Civil	Nr. 106, dt. 22.08.2012	145 dite	100 dite
	2	Vendim unifikues nr.3, date 29.06.2012	Civil	Nr. 179, dt. 11.11.2013	500 dite	465 dite
	3	Vendim unifikues nr.5, date 30.10.2012	Civil	Nr. 190, Dhjetor 2012 dalë nga shtypi me dt. 07.03.2013	127 dite	82 dite
2011	1	Vendim unifikues nr. 1, datë 17.1.2011	Civil	FZ Ekstra nr 88 pas 06.11.2012 (FZ nuk ka datë)	660 dite	615 dite
	2	Vendim unifikues nr.2, datë 21.01.2011	Civil	Nr. 114, dt. 17.09.2011	240 dite	195 dite
	3	Vendim unifikues nr.4, date 30.05.2011	Civil	Nr. 142, dt. 21.10.2011	142 dite	98 dite
	4	Vendim unifikues nr.5, date 31.05.2011	Civil	Nr. 184, dt. Dhjetor 2011 (ka dalë nga shtypi në 22.02.2012)	236 dite	191 dite
	5	Vendim unifikues nr. 6, datë 1.6.2011	Civil	Nr. 171 dt. 29.10.2013	880 dite	835 dite
	6	Vendim unifikues nr. 7, datë 1.6.2011	Civil	FZ Ekstra nr 88 pas 06.11.2012 (FZ nuk ka datë)	523 dite	478 dite
	7	Vendim unifikues nr.8, date 10.06.2011	Civil	Nr. 140, dt 14.10.2011	126 dite	81 dite
	8	Vendim unifikues nr. 1, datë 20.1.2011	penal	FZ Ekstra nr 84 dt 06.11.2012	657 dite	612 dite
	9	Vendim unifikues nr.2, date 24.01.2011	Penal	Nr. 140, dt. 14.10.2011	265 dite	220 dite
	10	Vendim unifikues nr.3, date 24.01.2011	Penal	Nr. 166, dt 27.12.2011	330 dite	285 dite
	11	Vendim unifikues nr. 4, datë 15.4 2011	penal	FZ Ekstra nr 84 dt 06.11.2012	570 dite	525 dite
	12	Vendim unifikues nr. 6, datë 30.9.2011	penal	FZ Ekstra nr 84 dt 06.11.2012	401 dite	356 dite
	13	Vendim unifikues nr.7 date 14.10.2011	Penal	Nr. 179, dhjetor 2011 (ka dalë nga shtypi në 22.01.2012)	98 dite	53 dite
TOTAL					6731 dite (18.4 vjet)	5797 (15.8 vjet)

Një tjetër koncept vlerësues, që INFOÇIP prezanton në këtë studim është **“matja e vonesës relative”** për botimin e VU në Fletore Zyrtare. Vonesa relative “skonton” paraprakisht nga përllogaritjet e vonesave, kohën prej 30 ditësh që ligji vendos në dispozicion të gjyqtarëve për të përfunduar arsyetimin e vendimit, nga momenti i mbylljes së shqyrtimit gjyqësor (neni 19/1). Po ashtu, kësaj kohe i “skontohen” edhe 15 ditë të tjera, që janë afatet brenda të cilave administrata e GJL ndërvepron me Qendrën e Botimeve Zyrtare për botimin e vendimit unifikues (5 ditë për institucionin dërgues dhe 10 ditë për QBZ, sipas nenin 5 dhe 6 të ligjit 96/2012 “Për Qendrën e Botimeve Zyrtare”).

*Mesatarja e vonesave relative për këto 21 vendime unifikuese rezulton të jetë **276 ditë** deri në botimin e secilës në F. Zyrtare*

*Në total, koha që ka kaluar deri sa këto 21 vendime unifikuese të botoheshin të gjitha në fletore zyrtare (pas skadimit të kohës për shpalljen e arsyetuar + kohën e dërgimit për botim), është **5797 ditë, ose 15.8 vjet.***

Me “rregull treshi”, po kaq kohë kanë pritur edhe palët, gjyqtarët e shkallëve më të ulëta, avokatët, praktikantët e së drejtës, juristët, studjuesit e jurisprudencës së GJL, etj, për të marrë përmes Fletores Zyrtare, 21 vendimet unifikuese të GJL të tre viteve të fundit, në formën e tyre përfundimtare

Vonesa më e madhe e konstatuar nga ky studim i takon botimit në FZ të VU nr.6, dt. 1/6/2011. Ky vendim rezulton të jetë botuar në fletoren zyrtare rreth 880 ditë (vonese absolute) pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor ose 835 ditë përtej skadimit të afateve ligjore për botimin e tij (përllogaritur strikt sipas përcaktimeve ligjore).

Vihet re megjithatë se në vitin e fundit ka një prirje drejt normalizimit të gjendjes. Gjatë vitit 2013, psh. VU civil nr. 4, dt. 10/12/2013 shënon një vonesë relative prej vetëm 41 ditësh deri në botimin përfundimtar të tij në FZ 216.



GJETJET E MONITORIMIT, 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në kuadër të këtij studimi, objekt vlerësimi janë edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Kjo gjykatë nuk bën pjesë në sistemin gjyqësor të zakonshëm, por ajo është autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj (*neni 2, ligji Nr. 8577/2000*).

Sa i takon vendimeve të GJK, ligji në fjalë përcakton se ato shpallen të arsyetuara dhe lexohen nga kryesuesi i seancës ose nga një gjyqtar i caktuar prej tij (*neni 72, para.6*). Vendimi nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në shqyrtimin e çështjes. Për shpalljen e vendimit njoftohen pjesëmarrësit në proces. Mungesa e tyre nuk pengon shpalljen e tij (*neni 72/ para 4*). Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij (*neni 26/1, ligji 8577*).

Pra, ligji 8577/2000 nuk e ndan në dy kohë shpalljen e një vendimi nga arsyetimi i tij. Nuk ka gjithashtu një afat në ligj që do lidhte mbylljen e shqyrtimit gjyqësor, marrjen e vendimit dhe arsyetimin e tij, hallka nëpër të cilat kalon si rregull çdo vendimarrje gjykate, përfshirë GJK.

Si rregull i përgjithshëm, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të hyjnë në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare. Këto të fundit botohen nga Qendra e Botimeve Zyrtare (QBZ), një institucion qeveritar varësie. Ligji organik i GJK, nuk i cakton asaj një afat brenda të cilit ajo të dërgojë për botim në FZ vendimet e saj. Paradoksisht, në marrdhënien mes GJK dhe QBZ, ligjvënësi ka zgjedhur që afatet për “dërguesin” t’i përcaktojë në ligjin e “marrësit” dhe anasjelltas; afatet e “marrësit” t’i caktojë në ligjin për “dërguesin”. Konkretisht, ligji i GJK i cakton 15 ditë afat QBZ të bëjë botimin e vendimeve të saj (*neni 26/2*), kurse ligji i QBZ i vendos 5 ditë afat GJK që kjo të dërgojë për botim në Fletore Zyrtare vendimet e saj (*neni 5/1*). Për më tepër, edhe rakordimi (sikronizimi) i këtyre afateve *sureale* është një ushtrim me vetë! Ligji për QBZ (*nr.96/2012*) e detyron këtë të fundit të bëjë botimin e akteve jo më vonë se

Nr. Vendimit	Data e vendimit te GJ. Kushtetuese	Nr. & Dt. e FZ ku eshte botuar	LLogaritur Ditë-vonesa
1	Dt.06.02.2013	N=13 dt.20.02.2013	14 dite
2	Dt.18.02.2013	N=23 dt.4.03.2013	14 dite
3	Dt.19.02.2013	N=23 dt.4.03.2013	13 dite
4	Dt.20.02.2013	N=23 dt.4.03.2013	12 dite
5	Dt.25.02.2013	N=23 dt.4.03.2013	7 dite
6	Dt.26.02.2013	N=23 dt.4.03.2013	6 dite
7	Dt.27.02.2013	N=23 dt.4.03.2013	5 dite
8	Dt.08.03.2013	N=39 dt.21.03.2013	13 dite
9	Dt.15.03.2013	N=41 dt.26.03.2013	11 dite
10	Dt.18.03.2013	N=41 dt.26.03.2013	8 dite
11	Dt.05.04.2013	N=51 dt.11.04.2013	6 dite
12	Dt.16.04.2013	N=60 dt.23.04.2013	7 dite
13	Dt.16.04.2013	N=60 dt.23.04.2013	7 dite
14	Dt.17.04.2013	N=60 dt.23.04.2013	6 dite
15	Dt.19.04.2013	N=60 dt.23.04.2013	4 dite
16	Dt.19.04.2013	N=60 dt.23.04.2013	4 dite
17	Dt.23.04.2013	N=68 dt.6.05.2013	13 dite
18	Dt.23.04.2013	N=68 dt.6.05.2013	13 dite
19	Dt.25.04.2013	N=68 dt.6.05.2013	11 dite
20	Dt.29.04.2013	N=73 dt.9.05.2013	10 dite
21	Dt.29.04.2013	N=73 dt.9.05.2013	10 dite
22	Dt.20.05.2013	N=89 dt.27.05.2013	7 dite
23	Dt.22.05.2013	N=89 dt.27.05.2013	5 dite
24	Dt.29.05.2013	N=94 dt.6.06.2013	8 dite
25	Dt.11.06.2013	N=103 dt.21.06.2013	10 dite
26	Dt.24.06.2013	N=105 dt.1.07.2013	7 dite
27	Dt.24.06.2013	N=105 dt.1.07.2013	7 dite
28	Dt.25.06.2013	N=105 dt.1.07.2013	6 dite
29	Dt.27.06.2013	N=106 dt.8.07.2013	11 dite
30	Dt.27.06.2013	N=106 dt.8.07.2013	11 dite
31	Dt.10.07.2013	N=118 dt.25.07.2013	15 dite
32	Dt.10.07.2013	N=118 dt.25.07.2013	15 dite
33	Dt.12.07.2013	N=124 dt.29.07.2013	17 dite
34	Dt.12.07.2013	N=124 dt.29.07.2013	17 dite
35	Dt.17.07.2013	N=127 dt.1.08.2013	15 dite
36	Dt.25.07.2013	N=127 dt.1.08.2013	7 dite
37	Dt.25.07.2013	N=125 dt.30.07.2013	5 dite
38	Dt.25.07.2013	N=128 dt.2.08.2013	8 dite
39	Dt.26.07.2013	N=128 dt.2.08.2013	7 dite
40	Dt.30.09.2013	N=163 dt.11.10.2013	11 dite
41	Dt.10.10.2013	N=168 dt.23.10.2013	13 dite
42	Dt.10.10.2013	N=168 dt.23.10.2013	13 dite
43	Dt.17.10.2013	N=168 dt.23.10.2013	6 dite
44	Dt.31.10.2013	N=178 dt.7.11.2013	7 dite
45	Dt.01.11.2013	N=181 dt.15.11.2013	14 dite
46	Dt.11.11.2013	N=181 dt.15.11.2013	4 dite
47	Dt.11.11.2013	N=181 dt.15.11.2013	4 dite
48	Dt.15.11.2013	N=189 dt.4.12.2013	19 dite
49	Dt.21.11.2013	N=189 dt.4.12.2013	13 dite
50	Dt.21.11.2013	N=189 dt.4.12.2013	13 dite
51	Dt.21.11.2013	N=189 dt.4.12.2013	13 dite
52	Dt.02.12.2013	N=196 dt.17.12.2013	15 dite
53	Dt.09.12.2013	N=196 dt.17.12.2013	8 dite
54	Dt.23.12.2013	N=208 dt.6.01.2014	14 dite
55	Dt.23.12.2013	N=208 dt.6.01.2014	14 dite

10 ditë nga mbërritja e tyre¹. Pra, sa kohë duhet pritur që një vendim i GJK të hyjë në fuqi përmes botimit në FZ, 15 ditë apo 20 ditë?! Cili ligj “prevalon” në afatet që cakton; ligji organik i GJL apo ligji “i thjeshtë” i QBZ. Rasti në fjalë dikton nevojën për harmonizim mes këtyre dy ligjeve, edhe sikur vetëm për rakordimin të afateve.

Megjithatë, në kuadër të vlerësimeve që merr përsipër të trajtojë ky studim, do të “fotografohet” situata që haset në praktikë sa i takon intervalit kohor që zakonisht konsumohet nga shpallja e arsyetuar e vendimit të GJK deri në hyrjen e tij në fuqi përmes botimit në FZ.

Konkretisht, gjatë vitit 2013 rezulton se në Fletore Zyrtare janë dërguar për botim 55 vendime të GJK. Vargu indeksues i tyre është i pandërprerë, çka sugjeron se botimi i tyre në FZ është konsistent dhe pa mungesa. Nga **kontrastimi** i datës së shpalljes së vendimit të GJK me datën e FZ në të cilën ai vendim është i botuar, rezulton se shumica dërrmuese e vendimeve të GJK në vitin 2013 janë të botuara brenda një afati 15 ditor. Përgjatë vitit bën vetëm vendimi i GJK nr.48, dt. 15.11.2013, botuar në FZ nr.189, dt 4.12.2013 dhe ku, me një përlogaritje të thjeshtë, rezulton se vendimi në fjalë është botuar 19 ditë pas shpalljes së tij. Edhe vendimet e GJK nr.33 dhe nr.34 rezultojnë se janë botuar në FZ 17 ditë nga shpallja e tyre. Afati më i shkurtër i botimit të një vendimi të GJK në Fletore Zyrtare është jo më pak 4 ditë gjatë vitit 2013 (*shih listën e detajuar majtas*).

Me një llogaritje të thjeshtë, rezulton se mesatarja e botimit në Fletore Zyrtare të vendimeve të GJK të dhëna gjatë vitit 2013 është 10 ditë.

Gjatë kohës që implementohej ky studim, GJK mori në shqyrtim kërkesën e një grupi prej 36 deputetësh, me objekt: Shfuqizim, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të aktit normativ të KM nr.5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; Vendimi u dha nga GJK më dt. 5 shkurt 2014 dhe shfuqizoi si antikushtetues Aktin Normativ me Fuqinë e Ligjit nr 5.

Për shkak të polemikave të mëdha që shoqëruan si aktin normative me fuqinë e ligjit (nr.5, dt 30/09/2013) ashtu edhe momentin e “shumëpritur” të vendimit të GJK mbi kushtetutshmërinë e aktit normative, në kuadër të këtij studimi, ky rast do të merret në analizë të posaçme në kapitullin e dytë (fq. 87). Në kuder të vlerësimeve që trajtohen në këtë kapitull, mund të thuhet se vendimi i GJK nr.5/2014 u botua (kupto: hyri në fuqi) plot 21 ditë pasi ai ishte shpallur publikisht në seancë, në prani të palëve ndërgjyqëse. Kjo kohë, e tejkalon pothuajse me dyfish mesataren e vitit 2013 për kohën e botimit të vendimeve të GJK në Fletore Zyrtare.

¹ Ligji nr. 96/2012, “për Qendrën e Botimeve Zyrtare”, Neni 6 “Afati i botimit”

1. Aktet e botueshme duhet të botohen pa vonesë pas përpunimit për botim, por sidoqoftë jo më vonë se 10 ditë nga data e ardhjes tyre, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.

2. Në rast të masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë dhe urgjence, Ministri i Drejtësisë urdhëron botimin e aktit brenda një afati më të shkurtër se afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.